

**RREGULLORE PËR  
DHËNIEN E LICENCAVE TË TRANSMETIMIT AUDIO PËR  
QËLLIME TË PËRKOSSHME DHE NEVOJA INSTITUCIONALE**

**KREU I  
TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Objekti**

Kjo rregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave të transmetimit audio për qëllime të përkohshme dhe nevoja institucionale publike.

**Neni 2  
Përkufizime**

Termet e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Neni 3  
Fusha e zbatimit**

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për dhënien e:

1. Licencave të transmetimit audio të përkohshme institucioneve publike për:
  - 1.1. Plotësimin e nevojave që lindin gjatë situatave të emergjencave civile;
  - 1.2. Sigurimin e nevojave të tjera të përkohshme.
2. Licencave për ofrimin e një shërbimi transmetimi audio, institucioneve të mëposhtme:
  - 2.1. Institucioneve të arsimit parauniversitar dhe arsimit të lartë publike;
  - 2.2. Institucioneve shëndetësore publike;
  - 2.3. Organeve të pushtetit qendror dhe vendor.

**Neni 4  
Shqyrtimi i kërkesave**

1. Shqyrtimi i kërkesave për licencë transmetimi audio për qëllime të përkohshme dhe nevoja institucionale, kryhet nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit (KSHD).
2. Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit ngrihet me urdhër të Kryetarit dhe përbëhet Zëvendëskryetari, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit dhe nga Drejtorët e Drejtorive të AMA-s/ nga 1(një) përfaqësues i çdo drejtorie të administratës.

3. Anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit shqyrtojnë të dhënat e paraqitura nga subjektet. Në rast se, Komisioni konstaton mangësi në dokumentacionin e aplikimit, i propozon Kryetarit të AMA-s, lënien e një afati 10 ditor subjektit aplikues për të kryer plotësimet e nevojshme.
4. Në kuadër të vlerësimit, Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit përgatit relacionin përmbledhës, i cili është i shoqëruar me propozimin përkatës dhe i'a përcjell AMA-s për vendimmarrje.

## **Neni 5 Cilësia e mbulimit**

1. Mbulim me sinjal radio FM tokësore, sipas Rekomandimit ITU-R, BS 412-9 të ITU, do të konsiderohet mbulimi i zonës së licencimit me intensitet fushe jo më të vogël se:
  - 70 dB $\mu$ V/m (mono) dhe 74 dB $\mu$ V/m (stereo) për qytete të mëdha;
  - 60 dB $\mu$ V/m (mono) dhe 66 dB $\mu$ V/m (stereo) për zona urbane;
  - 48 dB $\mu$ V/m (mono) dhe 54 dB $\mu$ V/m (stereo) për zona rurale;
  - 34 dB $\mu$ V/m (mono) dhe 48 dB $\mu$ V/m (stereo) për zona të thella të Shqipërisë.
2. Pajisjet e prodhimit e transmetimit të programeve audio FM duhet të sigurojnë zbatimin e standardeve e normave teknike në prodhim dhe transmetim të miratuara nga ETSI dhe organizatat e tjera të specializuara ndërkombëtare.
3. Pajisjet që do të përdoren duhet të projektohen, ndërtohen, mirëmbahen dhe shfrytëzohen në mënyrë që përdorimi i tyre të mos shkaktojë asnjë interferencë të dëmshme tek asnjë përdorues tjetër i spektrit të radiofrekuencave.

## **Neni 6 Standardet programore**

Subjektet e licencuar për transmetime audio për qëllime të përkohshme dhe nevoja institucionale janë të detyruar të respektojnë standardet e programeve, duke patur parasysh:

1. Nxitjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë dhe në veçanti të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të informimit.
2. Respektimin e paanshmërisë, plotësisë e pluralizmit të informacionit. Paraqitjen e fakteve dhe ngjarjeve në mënyrë të ndershme, inkurajimin në formimin e lirë të opinioneve, pa i shërbyer në mënyrë të njëanshme interesave të asnjë partie, organizate politike, grupimi ekonomik apo komuniteti e shoqate fetare;
3. Respektimin e mirëkuptimit dhe bashkekzistencës shoqërore të të gjithë individëve në Republikën e Shqipërisë;
4. Promovimin e kulturës kombëtare shqiptare dhe gjuhës shqiptare;
5. Respektimin e dinjitetit dhe të drejtave themelore të njeriut;
6. Respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
7. Respektimin e privatësisë së individit;
8. Respektimin e diversitetit fetar dhe racës;
9. Respektimin e ruajtjen e sekretit të burimeve të informacionit;
10. Respektimin e normave morale dhe etike të shoqërisë;
11. Respektimin e të drejtën e përgjigjes.

si dhe kërkesa të tjera, të përcaktuara në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Neni 7**  
**Njoftimi për fillimin e transmetimit**

Subjekti i licencuar për transmetime audio për qëllime të përkohshme dhe nevoja institucionale duhet të njoftojë AMA-n për fillimin e transmetimeve.

**KREU II**  
**LICENCAT E PËRKOHSHME TË TRANSMETIMIT AUDIO**

**Neni 8**  
**Zona e mbulimit**

Licenca e përkohshme e transmetimit audio jepet për të mbuluar me sinjal audio hapësirën deri në një qark për shërbim transmetimi audio lokal dhe deri në katër qarqe me vijimësi gjeografike për një shërbim transmetimi audio rajonal.

**Neni 9**  
**Licencimi**

Të drejtën për t’u pajisur me licencë të përkohshme transmetimi audio e kanë institucionet publike të mëposhtme:

1. Organet e pushtetit qendror dhe vendor të zonës ku është shpallur gjendja e emergjencës.
2. Organet e pushtetit qendror dhe vendor në rastin e aktiviteteve të organizuara prej tyre.

**Neni 10**  
**Kërkesa**

Subjektet sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje paraqesin kërkesë pranë AMA-s për licencë të përkohshme transmetimi audio:

1. Në rastin e gjendjes së emergjencave civile, kërkesa, paraqitet menjëherë dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:
  - a. Subjektin kërkues;
  - b. Zonën e mbulimit për të cilën shfaqet interes;
  - c. Emërtimin e programit;
  - d. Afatin e licencës;
  - e. Informacion mbi nevojën për mbulimin me shërbim audio të zonës;
  - f. Objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit, projekt-idenë e ndërtimit të rrjetit të transmetimit audio ku përfshihen studioja e transmetimit dhe pajisjet transmetuese.

2. Në rastin e aktiviteteve të tjera, kërkesa, paraqitet jo më vonë se 30 ditë përpara datës së zhvillimit të aktivitetit dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- a. Subjektin kërkues;
- b. Zonën e mbulimit për të cilën shfaqet interes;
- c. Afatin e licencës;
- d. Emërtimin e programit;
- e. Informacion mbi aktivitetin që do të zhvillohet dhe përfitimet e pritshme sociale, ekonomike, kulturore në zonën e licencimit.
- f. Objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit, projekt-idenë e ndërtimit të rrjetit të transmetimit audio ku përfshihen studioja e transmetimit dhe pajisjet transmetuese.

## **Neni 11**

### **Vendimi për dhënien e licencave të përkohshme**

1. Në rastin e gjendjes së emergjencave civile:

1.1 AMA, në përputhje me planin e përdorimit të frekuencave të destinuara për transmetimet audio, vendos për dhënien e licencës së përkohshme të transmetimit audio në rastin e emergjencave civile jo më vonë se 7 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës.

1.2 AMA, në rast të mungesës së frekuencave të lira, kërkon nga OSHMA-të që ushtrojnë veprimtari audio dhe audiovizive në zonën ku është shpallur emergjenca civile të transmetojnë pa shpërblim komunikata të shkurtra, që paraqesin interes për publikun e zonës që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit, fatkeqësitë natyrore dhe njerëzore, rendin publik e sigurinë kombëtare. Organet e pushtetit vendor kanë të drejtë të kërkojnë hapësira kohore më të mëdha për trajtimin e çështjeve të emergjencës civile, mbi bazën e marrëveshjes me OSHMA-në/të e zonës.

1.3 AMA, në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme, mbështetur në nenin 89 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për plotësimin e kërkesave për licenca të përkohshme, vendos pezullimin e licencës së transmetimit të një ose më shumë OSHMA-ve të zonës.

2. Në rastin e organizimit të aktiviteteve:

2.1 AMA, në përputhje me planin e përdorimit të frekuencave të destinuara për transmetimet audio, vendos për dhënien e licencës së përkohshme të transmetimit audio në rastin e zhvillimit të aktiviteteve të veçanta sportive, kulturore – artistike, argëtuese etj (kombëtare/ndërkombëtare).

2.2 AMA, në rast të mungesës së frekuencave lira, refuzon kërkesën për licencë.

2.3 Në rastin e paraqitjes së dy ose më shumë kërkesave për licencë transmetimi audio të përkohshme dhe disponibiliteti i frekuencave nuk lejon dhënien e dy ose më shumë licencave të përkohshme, AMA vendos dhënien e licencës së përkohshme të transmetimit, duke u bazuar në prioritetin e aktivitetit që kërkohet të mbulohet me shërbim transmetimi audio.

## **Neni 12**

### **Kufizime**

Licencat e përkohshme të transmetimit audio nuk jepen 6 muaj para datës së zhvillimit të zgjedhjeve vendore apo zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare, me përjashtim të

rasteve që lidhen me mbrojtjen e shëndetit, fatkeqësive natyrore dhe njerëzore, rendin publik dhe sigurinë kombëtare.

### **Neni 13**

#### **Afati i licencës së përkohshme të transmetimit audio**

Licenca e përkohshme e transmetimit audio pavarësisht subjektit të licencuar jepet me afat:

- a) deri në 60 ditë brenda një viti kalendarik, kur zona e mbulimit është deri në 4 qarqe;
- b) deri në 120 ditë brenda një viti kalendarik, kur zona e mbulimit është deri në 1 qark.

## **KREU II**

### **LICENCA E TRANSMETIMIT AUDIO PËR QËLLIME INSTITUCIONALE**

#### **Neni 14**

##### **Zona e mbulimit**

1. Licenca e transmetimit audio për nevoja institucionale jepet për të mbuluar me sinjal audio hapësirën nga një lagje deri në një qytet duke përdorur stacione transmetues me fuqi të ulët.
2. Shërbimi i transmetimit audio për nevoja institucionale ka për qëllim t'i shërbejë institucioneve arsimore, shëndetësore, të pushtetit qendror dhe vendor etj.

#### **Neni 15**

##### **Kërkesa të përgjithshme të aplikimit për licencë transmetimi audio**

1. Të drejtën për t'u pajisur me licencë transmetimi audio për nevoja institucionale e kanë subjektet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të kësaj rregulloreje.
2. Kërkesa për licencë transmetimi audio për nevoja institucionale, paraqitet pranë AMA-s dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:
  - a. Subjektin kërkues, emërtimin, vendndodhjen, formën ligjore të tij, për subjektet jopublike ekstrakti i QKR-së i thjeshtë dhe historik;
  - b. Emërtimin e programit;
  - c. Kohëzgjatja e transmetimit të programit brenda 24 orëve dhe brenda 12 muajve;
  - d. Planifikimin financiar mbi shpenzimet për shërbimin e kërkuar;
  - e. Zonën e mbulimit për të cilën shfaqet interes;
  - f. Informacion mbi objektin e veprimtarisë dhe nevojën për mbështetjen me shërbim audio;
  - g. Përmbajtjen e programeve që do të transmetohen dhe strukturën programore të propozuar për transmetim, të cilat shprehin qartë pluralizmin në tërësinë e tyre dhe paanësinë informacionit;
  - h. Mënyra e organizimit të shërbimit audio (stafi editorial për këtë shërbim, stafi teknik etj);

- i. Objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit, projekt-idenë e ndërtimit të rrjetit të transmetimit audio ku përfshihen studioja e transmetimit dhe pajisjet transmetuese.

### **Neni 16**

#### **Shqyrtimi i kërkesave**

1. Kërkesat për licencë transmetimi audio për nevoja institucionale shqyrtohen brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së tyre.
2. Në rast se për të njëjtën zonë mbulimi, janë paraqitur më tepër kërkesa sesa mund të përballohen nga spektri disponibël i frekuencave audio, AMA, aplikon procedurën e përzgjedhjes, mbështetur në parimet e barazisë, transparencës dhe jo diskriminimit.

### **Neni 17**

#### **Vendimi për dhënien e licencës të transmetimit audio**

AMA vendos për dhënien ose jo të licencës së transmetimit audio për nevoja institucionale brenda 50 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

### **Neni 18**

#### **Afati i licencave të transmetimit audio**

Licenca e transmetimit audio për nevoja institucionale jepet me afat deri në 3 vjet me të drejtë rinovimi.

### **Neni 19**

#### **Detyrimet financiare**

1. Pagesa për përpunimin e dokumentacionit për licencë transmetimi audio për nevoja institucionale kryhet në momentin e aplikimit; pagesa për marrjen e licencës së transmetimit audio për qëllime të përkohshme kryhet menjëherë pas vendimit për dhënien e licencës.
2. Pagesa vjetore për licencë transmetimi audio për nevoja institucionale kryhet brenda tremujorit të parë të vitit kalendarik. Në rastin kur pagesa kryhet pas kalimit të këtij afati, aplikohet një kamatë vonese në masën 0.1% të vlerës së pagesës vjetore për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 30% e vlerës së detyrimit financiar.
3. Masat e pagesave për llojet e shërbimeve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, përcaktohen në vendimin/vendimet e pagesave në fuqi.

### **Neni 20**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të AMA-s.